



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 307/7 prot.

Tiranë, më 3.8.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Bledar Bejko
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 19.7.2022, është njoftuar vendimi nr. 535, datë 26.5.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Bledar Bejko, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës dhe, në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës, së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.
3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar

si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI¹, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë”, ka referuar:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. ka mosdeklarim pasurie ndër vite;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, fillimisht me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit”. Në vijim të informacioneve të ardhura, në kohështirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit, DSIK ka dërguar një raport të dytë të përditësuar,² ku referon se subjekti mund të jetë përfshirë në veprimtari korruptive, duke ndryshuar kështu konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

3.3 KLP³, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

4.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

5. Nisur nga përfundimet e mësipërme, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në bazë të germës “a”, të pikës 1 dhe 4, të nenit 59⁴, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

¹ Akti i përfundimit të kontrollit nr. ***/** prot., datë **.12.2018.

² Raporti nr.*** prot., datë **.9.2020, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë **.12.2020.

³ Raport i KLP-së, përcjellë me shkresën nr. ***/* prot., datë **.5.2021.

⁴ Nga përmbajtja e vendimit duket se referenca mbi pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duhet të ketë qenë lapsus.

[...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Bejko, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor, Durrës [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që iu njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 535/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Lidhur me gjetjet në kontrollin e pasurisë

12. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie”, dorëzuar në ILDKPKI, më datë **.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën **.1.2017.

13. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet sa në vijim:

14. Apartament me sip. 96.5 m² në ***, kompleksi “*** **”, Tiranë

14.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja, kanë deklaruar: Apartament 96.5 m² në ***, “*** **”, Tiranë. Blerë në vlerën 87.000 euro, me kontratë shitje nr. ***rep., nr. *** kol., datë **.10.2008. Transferuar nëpërmjet *** Bank, 47.000 euro nga prindërit e mi, ***.***., nga shitja e një apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol, datë **.11.2007, në shumën 90.000 euro (blerë 34.000 USD, nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2004), ndërsa 10.000 euro janë transferuar nga llogaria e Bledar Bejko pranë *** Bank. Kjo shumë ka ardhur nga kredi konsumatorë, e marrë në emër të Bledar Bejko, me kontratë kredie bankare konsumatore nr.***/**.4.2008, në shumën 4.000 euro, dhe mbyllur para afatit, më datë **.8.2008, dhe kredi konsumatore në emër të ***.***., me kontratë kredie konsumatore nr. ***/**.4.2008, në shumën 5.000 euro, dhe shlyer para afatit, më datë **.8.2008. Këto dy kredi u shlyen nga fondet të familjes së ***.***.***. Diferenca 30.000 euro është marrë kredi te *** Bank për blerje apartamenti⁵. Vlera 87.000 euro, pjesa takuese 50%⁶.

14.2 Në DV-2008, subjekti ka deklaruar: Blerje apartament banimi me sip. 101 m², ndodhur në Komuna ***, blloku “*** **”, në vlerën totale 87.000 euro. 57.000 euro janë dhënë *cash*, kursime nga pasuria e prindërve të mi, nga shitja e një apartamenti 100 m² në rr. “***. ***”, në dhjetor 2007, në vlerën 81.000 euro, diferenca kredi 30.000 euro në *** Bank, në shkurt 2009. Pjesa takuese 100%.

14.3 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezultojnë transaksionet si vijon:

14.3.1 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja/bashkëshortja e tij, fillimisht kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes nr.*** rep., nr. ***/* kol., datë **.4.2008, me shoqërinë “***” sh.p.k., për blerjen e pasurisë apartament me sip.103.22 m², ndodhur në rr. “*** e ***”, Tiranë në vlerën 85.000 euro. Sipas kësaj kontrate, kësti i parë është likuiduar nga porositësit, në shumën 20.000 euro, në momentin e redaktimit të kësaj kontrate.

14.3.2 Në datën **.4.2008, shtetasi ***.***. (babai i subjektit), ka paguar nga llogaria e tij bankare në *** Bank, shumën 8.000 euro, në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin: “*Kapar, garanci ap. 2+1 deri **/04/2008 ku do të kryhet kontrata*”.

14.3.3 Në datën **.4.2008, subjekti rivlerësimit ka paguar nga llogaria e tij bankare në *** Bank, shumën 9.000 euro, në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin: “*Pagesë blerje apartamenti kontratë sipërmarrje **/04/2008*”. Paguesa në shumën 9.000 euro ka si burim dy kredi të marra nga subjekti dhe personi i lidhur, në *** Bank, në prill 2008. Të dyja këto kredi rezultojnë të jenë mbyllur para afatit, në gusht 2008, me fonde të depozituara *cash* në llogari nga subjekti dhe personi i lidhur.

14.3.4 Kontrata me shoqërinë “***” sh.p.k. është revokuar me kontratën nr. *** rep., nr. ***/* kol., datë **.10.2008, dhe në datën **.10.2008 janë kthyer shumat 10.000 euro në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, dhe 10.000 euro në llogarinë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit, në *** Bank.

14.3.5 Në DV-2008 nuk rezultojnë të jetë deklaruar marrëdhënia kontraktore me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe as burimi i krijimit të pagesës në shumën 20.000 euro. Gjithashtu, në këtë

⁵ Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe shpenzime mobilimi në shumën 5.000 euro.

⁶ ASHK, me shkresën nr.***/* prot., datë **.2.2020, konfirmon se shtetasi B. B. ka të regjistruar pasuri të paluajtshme me nr.***/*+*-*, volum **, faqe ***, lloji i pasurisë “Apartament” me sip. 96,5 m², Z. K. ***.

deklaratë nuk rezulton të jetë deklaruar marrja e kredive në shumën totale 9.000 euro, shlyerja e parakohshme e tyre dhe as burimi i krijimit që ka shërbyer për shlyerjen e këtyre kredive.

14.3.6 Me Kontratë shitje apartamenti nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.10.2008, subjekti i rivlerësimit ka blerë një apartament me sip. 96,5 m², me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., me çmim shitje 87.000 euro.

14.3.7 Lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri rezulton se: (i) Nga llogaria bankare e ***.***. gjatë periudhës shtator-tetor 2010 janë kryer 4 transferta bankare, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., në total në vlerën 47.000 euro, me përshkrimin: “*Transfertë te *** ***, Këst blerje apartamenti 101 m,² kati 2, B/Bejko*”; (ii) Shuma 10.000 euro është transferuar nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e shoqërisë në datën **.10.2008, (iii) Ndërsa diferenca 30.000 euro është paguar në datën **.2.2009, me burim kredinë e marrë në *** Bank.

14.3.8 Lidhur me burimin e krijimit të shumës 47.000 euro, deklaruar në “Vetting”, dhënë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë “Apartament” në vitin 2007, në vlerën 90.000 euro. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se për shitjen e kësaj pasurie janë administruar dy kontrata: (i) Kontratë premtim shitje nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.11.2007, për apartament me sip.100 m² në rr. “****. ***,” me palë shitëse ***.***., dhe palë blerëse ***. ***., në vlerën 90.000 euro dhe (ii) Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.11.2007, në vlerën 38.000 USD, sipas së cilës është regjistruar kalimi i pronësisë në ZVRPP. Në këto kushte, meqenëse rezulton se është paguar tatim mbi çmimin e shitjes 38.000 USD, Komisioni, në analizën financiare paraprake të subjektit të rivlerësimit, ka përfshirë vetëm shumën 38.000 USD si të ardhura me burim të ligjshëm. Për pasojë ka rezultuar se nuk provohet burimi i ligjshëm për vlerën 2.333.098 lekë, si diferencë e 47.000 euro – 38.000 dollarë.

14.3.9 Sa i përket burimit tjetër të krijimit të pasurisë, në shumën 10.000 euro⁷, rezulton se dy kreditë e marra në *** Bank, fillimisht, kanë shërbyer për pagesën e kësaj të parë të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe, në vijim, shuma e kthyer pas revokimit të kësaj kontrate, u përdor si burim për kontratën e re.

14.4 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me sa vijon: (i) Duket se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare në shumën 2.893.370 lekë, për të investuar në blerjen e apartamentit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare për vitet 2008-2009. Nga kjo shumë, pamundësia financiare prej 2.333.098 lekë, vjen si rezultat i mospagimit të tatimit mbi fitimin e realizuar nga prindërit e subjektit, nga shitja e pasurisë së tyre, *apartament*, në vlerën 90.000 euro dhe jo 38.000 USD; (ii) Duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me shumën e dhënë nga prindërit e tij dhe mënyrën e marrjes së saj, e përdorur për shlyerjen e vlerës së apartamentit në vitin 2008, pasi në Deklaratën e interesave private periodike vjetore 2008 deklarohet 57.000 euro e paguar *cash*, ndërsa në Deklaratën “Vetting” deklarohet 47.000 euro me transferta bankare; (iii) Duket se subjekti nuk ka deklaruar në DV-2008, dy kreditë konsumatore të marra në *** Bank, në shumën totale 9.000 euro, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit. (iv) Duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për burimin e përdorur për shlyerjet e dy kredive në shumën 9.000

⁷ Rezulton se dy kreditë e marra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të janë në shumën 9.000 euro, ndërsa pas revokimit të kontratës me shoqërinë “****” sh.p.k, në llogarinë e subjektit, janë kthyer 1.000 euro më shumë.

euro, pasi në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar se ato janë shlyer brenda vitit, me burim nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, ndërsa gjatë hetimit deklaroi me burim nga kursimet e prindërve të tij; (v) Duket se mungon dokumentacioni justifikues nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së përdorur për mbylljen e dy kredive (5.000 dhe 4.000 euro).

14.5 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ, ku, ndër të tjera, ka deklaruar⁸: [...] *prindërit e mi në vitin 2008 më kanë dhuruar shumën 57.000 euro, shumë e cila është deklaruar rregullisht në DPV-në e këtij viti. Vlera 47,000 euro është transferuar nga llogaria e babait tim në llogarinë e shoqërisë me transfertë bankare. Shuma 9.000 euro më është dhënë cash prej tij dhe kjo shumë ka shërbyer për shlyerjen e dy kredive (përkatësisht 4000 dhe 5000 euro), të cilat i kemi mbyllur brenda vitit. Ndërsa 1.000 euro (nga shuma 11,000 euro që babai kishte paguar në llogarinë e shoqërisë ***) kaluan në llogarinë time me transfertë bankare. Pra, në shoqërinë *** u paguan në vitin 2008, 20.000 euro (11,000 euro nga babai im dhe 9.000 euro nga unë) ... shuma e dhuruar nga babai ka si burim kursime nga pasuria e prindërve të mi (pra, në mënyrë të përgjithshme, nga të gjitha pasuritë) ... Veprimet për shitjen e pasurisë janë kryer nga nëna ime, e cila më ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes. Siç vërtetohet gjatë hetimit administrativ, vlera reale e pasurisë së shitur në vitin 2008 është 90,000 euro. Nuk kam pasur asnjë dijeni në lidhje me kontratën që referon Komisioni [...].*

14.5.1 Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se është lapsus në Deklaratën “Vetting” fjalia: “kredia u shlye nga fondet të familjes së ***, ***, ***.” (personi i lidhur, bashkëjetuesja). Ndërkohë që shlyerja e dy kredive në vlerën 9.000 euro ka si burim shumën e kaluar me dhurim nga babai i tij. Lidhur me detyrimin për të deklaruar kreditë në vitin 2008, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur detyrim të deklarojë marrjen e këtyre kredive, për shkak se në fund të vitit nuk ka pasur detyrim ndaj bankës.

14.6 Komisioni, në analizë të provave dhe parashtrimeve të depozituara nga subjekti, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për dhurimin e bërë në shumën 47.000 euro, duke e përfshirë këtë shumë në mesin e burimeve të ligjshme. Gjithashtu ka analizuar dhe vlerësuar faktet sa i takon burimit të përdorur për shlyerjen e dy kredive, pasi subjekti ka deklaruar se ato janë shlyer nga fondet e familjes së bashkëshortes, ndërkohë ky deklaram pretendohet si lapsus, pasi janë shlyer nga prindërit e subjektit të rivlerësimit. Komisioni, në referim të deklaramit të subjektit në vitin 2008, se prindërit i kanë dhuruar shumën 57.000 euro, por edhe nga analiza financiare e kryer, ka konkluduar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare të dhurojnë shumën totale 57.000 euro, ndërsa nuk rezulton të ketë kryer një analizë financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të familjes *** (familja e bashkëjetueses/bashkëshortes), për mbulimin me burime të ligjshme të shumës 9.000 euro. Në këtë kontekst ka vlerësuar se lapsusi i pretenduar për shumën 10.000 euro bëhet i besueshëm. Në konkluzion, Komisioni ka vlerësuar se deklaramit e subjektit, edhe në eventualitetin e çmuarjes si pasaktësi të deklaramit të tij, për sa kohë kjo e fundit nuk rezultoi e shoqëruar me mungesë financiare, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e tij⁹.

⁸ Referohuni shpjegimeve të subjektit f. 1-11, të prapësimeve, lidhur me rezultatet e hetimit administrativ.

⁹ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 18-24, të vendimit.

14.7 Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm për sa argumentuar në vijim:

14.7.1 Në DV-2008 rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., pagesën në shumën 20.000¹⁰ euro, të kryer në prill të vitit 2008, si dhe burimin e krijimit të saj. Kjo marrëdhënie kontraktuale nuk është saktësuar nga subjekti as në Deklaratën “Vetting”, në kushtet kur shuma e kthyer nga kjo shoqëri ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit që subjekti i rivlerësimit ka aktualisht në pronësi.

14.7.2 Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DV-2008 kreditë konsumatorë, në shumën totale 9.000 euro, të marra nga ai dhe personi i lidhur me të, në *** Bank, shlyerjen e parakohshme të kredive konsumatore dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre.

14.7.3 Për herë të parë, burimi i krijimit për shlyerjen e parakohshme të kredive është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në Deklaratën “Vetting”, me burim fondet e familjes së znj. ***.***.***. Ky burim krijimi është i ndryshëm nga burimi i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, çka bie në kundërshtim me parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet qartë se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

14.7.4 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se mosdeklarimet në Deklaratat periodike vjetore, deklaramet e pasakta dhe kontradiktore në Deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit administrativ, mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaramet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume. Pasaktësitë në deklaramet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklaramin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, germa “a”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

15. Automjet tip “Daimler Chrysler, * **”, blerë në Gjermani nga subjekti i rivlerësimit më datë **.4.2007**

15.1 ILDKPKI, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.10.2020, ka vënë në dispozicion të Komisionit, ndër të tjera, dhe procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit të deklaramit të pasurive, që mban datën **.4.2016. Nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se subjekti, në përgjigje të pyetjes nr.14, “Keni gjë për të shtuar?”, është përgjigjur se: [...] *Dua të shtoj, në vitin 2007 kam blerë një automjet, tip Mercedes Benz, në Gjermani, të cilin e kam sjellë në Shqipëri. Por sqaroj se të gjitha shpenzimet i ka mbuluar shtetasi ***.***., sepse automjeti ishte i destinuar për të. Automjeti ka hyrë nga Murriqani dhe zhdoganimi është bërë nga ana ime, sepse isha personi që e kisha blerë në Gjermani, pasi është bërë zhdoganimi, është bërë edhe kontrata e shitjes me shtetasin ***.***. [...].* Subjekti ka paraqitur si dokumentacion:

¹⁰ Nga aktet rezulton se janë paguar 8.000 euro nga llogaria e babait të subjektit të rivlerësimit, 9.000 euro nga llogaria e subjektit të rivlerësimit për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., dhe nuk ka të dhëna mbi diferencën për shumën 3.000 euro.

(i) Kontratë shitblerje automjeti nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.5.2007, hartuar nga noteri ***.***., lidhur mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e shitësit, dhe shtetasit ***.***., në cilësinë e blerësit. Referuar kësaj kontrate, palët të panjohur midis tyre kanë rënë dakord të lidhin këtë kontratë shitje automjeti, Daimler Chrysler, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e shitësit, ia shet blerësit në vlerën 500.000 lekë.

(ii) Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.5.2007, hartuar nga noteri ***.***., në të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se kam marrë në datën **.4.2007, nga z. ***.***., shumën prej 2.000.000 lekë, si vlerë për blerjen e një automjeti tip “Mercedes Benz *** ***”, në Gjermani. Kjo deklaratë është firmosur dhe nga z. ***.***.

15.2 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.11.2021, i ka përcjellë Komisionit dosjen e mjetit, nga ku rezultoi se: (i) ky automjet është blerë në Gjermani, më datë **.4.2007, në vlerën 11.950 euro; (ii) mjeti është zhdoganuar nga subjekti në datë **.5.2007, duke paguar shumën 458.052 lekë. Vlera totale e shpenzuar nga subjekti për këtë mjet, (blerja + zhdoganim) është 1.969.608 lekë (1.511.556 + 458.052).

15.3 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me sa vijon: (i) *Për sa më sipër duket se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit *** nuk përputhet me vlerën reale të shpenzuar për blerjen e automjetit në shtetin gjerman. Jepni shpjegimet tuaja lidhur me këtë veprim kontraktor, i cili duket se pasqyron veprim fiktiv.* (ii) *Duket se shuma 2.000.000 lekë, dhënë nga shtetasi ***, sipas deklaratës noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.5.2007, për blerjen e këtij automjeti, e tejkalon limitin e lejuar për t’u kaluar përtej territorit shqiptar, pa u deklaruar.*

15.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, të datës 22.3.2021, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Automjeti ka kushtuar 2.000.000 lekë dhe shënimi në kontratën e shitjes duhet të jetë lapsus. Unë e kam blerë këtë automjet vetëm për të ndihmuar shokun tim ***.***. Dhe, përveç mundimeve dhe kohës së shpenzuar, nuk kam pasur asnjë përfitim. Automjetin ia kam dorëzuar ***, sapo jam kthyer nga Gjermania. ...Kontrata dhe deklarata noteriale u përpiluan njëra pas tjetrës dhe ashtu si kontrata, edhe deklarata noteriale janë akte publike. ...Siç rezultoi nga sistemi TIMS, unë kam udhëtuar së bashku me bashkëjetuesen time, znj. *** *** ...Me sa kujtoj, kemi marrë me vete secili shumën rreth 7.000 euro, shuma e cila nuk kalon kufirin e deklaramit. [...]*

15.5 Komisioni, duke çmuar rrethana si: [...] (i) *nuk rezultoi që subjekti të ketë përdorur apo përfituar të ardhura nga shitja e automjetit;* (ii) *vlera e blerjes së automjetit së bashku me taksat dhe detyrimet doganore, në total përbëjnë shumën 2.000.000 lekë, të deklaruara nga shtetasi *** ***, sipas deklaratës noteriale;* (iii) *konfirmohet fakti se i njëjti noter ka hartuar dhe nënshkruar aktet noteriale, përfshirë deklaratën për dhënien e shumës 2.000.000 lekë dhe kontratën për shitjen në favor të shtetasit ***.***., në shumën 500.000 lekë, dhe se kjo vlerë në kontratën e shitjes duket se nuk ka ndikuar në shmangien e ndonjë takse apo detyrimi doganor [...], ka konkluduar se në kushte të tilla nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të passillnin një vlerësim ndryshe për penalizimin e subjektit.*

15.6 Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, për sa në vijim:

15.6.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, blerjen, burimin e krijimit, shitjen dhe as të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti. Ekzistenca e akteve noteriale me përshkrimin e të drejtave të subjektit mbi këtë pasuri tregon, në kuptim formal, deri në provimin e së kundërtës, se këto të drejta i përkasin pikërisht subjektit të rivlerësimit, prandaj ai kishte detyrimin, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, t'i deklaronte ato.

15.6.2 Pretendimet e subjektit mbi konsiderimin *si lapsus* të shumës 500.000 lekë, të parashikuar në kontratën e shitjes, mbeten në nivel deklarativ dhe duket se subjekti kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së luajtshme. Në kontekst të kësaj situatë faktike dhe ligjore, në dijëni të plotë të subjektit të rivlerësimit pas komunikimeve me institucionin përgjegjës për kontrollin e verifikimin e pasurisë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kishte ndërgjegjësimin e duhur për të deklaruar këtë marrëdhënie të tij me këtë pasuri në Deklaratën “Vetting”, qoftë edhe sikur të bënte në të shpjegimet e nevojshme apo të përshtatshme të rastit, sipas pretendimit të tij gjatë hetimit administrativ.

15.6.3 Deklarimet e subjektit se *e kam blerë këtë automjet vetëm për të ndihmuar shokun tim, ***.***.*, bien ndesh me përmbajtjen e kontratës, ku referohet se palët nuk njihen. Në këto rrethana mbetet e paqartë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin ***.***.

15.7 Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, e bëjnë deklarimin e subjektit të rivlerësimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

16. Automjeti tip “Mercedes Benz”, me targa belge, * *****

16.1 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard, ka deklaruar¹¹: *Në vitin 2008 i kam marrë në përdorim për provë një makinë Mercedes Benz, një shtetasi të panjohur mirë nga unë, i quajtur ***. Takimi është bërë pranë Zogu i Zi, Tiranë, në prani të shtetasit ***. ***. Mjeti kishte targa belge, vit 1993 i modifikuar 95, i pazhdoganuar. Rreth 2-3 ditë më pas konstatoj një mëngjes se ma kishin vjedhur poshtë shtëpisë. I kam bërë pagesë rreth 100.000 lekë këtij personi, pasi kjo ishte vlera e mjetit si i amortizuar edhe pa targa. Nuk bëmë kontratë.*

16.2 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, lidhur me identitetin e plotë të shtetasit “****” dhe marrëdhënien që ka pasur me shtetasin ***.***., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *[...] Emri i saktë i ****, marrë për provë makinë Mercedes Benz, nuk më kujtohet emri. Lidhja me ***.***., për të cilin kam deklaruar që ka qenë prezent me shtetasin ****, e kam njohur aty ishte i rastësishëm, s'kishte asnjë rol, ishte i njohur i atij personit që quhej *** [...].*

16.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur vërtetimin nr. ****-* prot., ***.***., datë *.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, e cila, në përgjigje të kërkesës së subjektit, ka bërë me dije se: *[...] Mbi bazën e materialit referues nga Drejtoria e Policisë Tiranë është regjistruar procedimi penal nr.*** i vitit 2008, për veprën penale “Vjedhja”, të parashikuar nga neni 134 i K. Penal, i cili ka të bëjë me vjedhjen e mjetit me*

¹¹ Në përgjigje të pyetjes nr. 8: *A keni përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër?*

targa belge, *** ***, në pronësi të shtetasit Bledar Bejko. Në datë **.01.2008 është vendosur pezullimi i hetimeve për moszbulim të autorit të veprës penale [...].

16.3 Komisioni, në vijim të hetimit administrativ, në PyetëSORIN nr. 6, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitohet dokumentacion për të qartësuar rrethanën konkrete se si ra në kontakt me shtetasin “***”, të panjohur mirë prej tij, si dhe nëse ka hetuar, pushuar, mosfilluar etj., ndonjë çështje penale në ngarkim apo të kallëzuar ndaj shtetasit ***, si dhe ndaj shtetasit ***,***.

16.3.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është përgjigjur se: [...] *Mjetin e kam parë në një lavazh, në rrugë, tek Zogu i Zi, dhe jam i interesuar për ta blerë. Personi që e dispononte, më kujtohet që quhej *** dhe biseduam për mjetin. Aty i pranishëm ishte dhe shtetasi ***,***, po lante mjetin dhe dëgjoi bisedën, më pa e pashë dhe asgjë tjetër. Shtetasin ***,***. e kam njohur si deklarues rreth dy vite më parë. ... Dua të theksoj se ky procedim ishte regjistruar nga zv. drejtuesi i Prokurorisë për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i K. Penal, megjithëse mendimi im ishte se ndodheshim përpara kundërvajtjes penale “Plagosje e lehtë e kryer e dashje” sipas nenit 89 të K. Penal... Me vendimin tim, ky procedim është pushuar, vendimi iu është njoftuar palëve, të cilët nuk e kanë ankimuar...Nuk pati asnjë ndikim nga shtetasi ***, që ishte aty në marrëveshjen tonë. Emrin e shtetasit ***. e përmenda si mënyrë për të krijuar bindjen mbi vërtetësinë e deklaramit tim, ndërsa po shpjegoja kushtet që nuk më kujtohet emri i plotë i shtetasit *** dhe nuk kisha adresë ose njohje me të. Shtetasi ***, nuk ka pasur ndonjë ndikim në këtë blerje. Nuk kish përse, pasi nuk i kam bërë favor në çështje, por kam marrë një vendim të drejtë për të dhe shtetasin tjetër [...].*

16.3.2 Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur pyetësorit, ndër të tjera, ka përcjellë përgjigjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, mbi procedimin penal nr.***, të vitit 2006, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i K. Penal, i cili është pushuar më datë **.8.2006, për shtetasin ***,***. Bashkëlidhur është dërguar një kopje e fashikullit të pushimit të këtij procedimi penal.

16.4 Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se, në lidhje me deklaramin e subjektit të rivlerësimit në PyetëSORIN Standard (nr.1), për përdorimin e automjetit me targa belge, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të depozituar prej tij, si dhe dokumentacionit të administruar nga agjencitë ligjzbatuese, Komisioni vërejtë se provat e administruara nuk nxorën në pah ndonjë të dhënë që mund të cenonte ndonjë nga komponentët e kritereve të vlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

16.5 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se duket se rezultojnë disa rrethana, të mbështetura nga aktet në dosje, të cilat, të analizuar së bashku, më së paku, ndikojnë në perceptimin negativ të publikut mbi përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e subjektit të rivlerësimit, konkretisht:

16.5.1 Subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin mbi kallëzimin e krimit të kryer, të referuar dhe nënshkruar nga ai, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Seksioni kundër vjedhjeve të automjeteve, që mban datën **.1.2008, duke mbajtur përgjegjësi për kallëzim të rremë sipas nenit 305 të K. Penal, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... *Jap këtë kallëzim për vjedhjen e mjetit tim Mercedes Benz 250, E klas, diesel me targa belge *** ***, nuk më kujtohet numri i targës, por ishte e kuqe. Mjetit i kisha vënë një sistem alarmi, i cili i siguronte dyert dhe bllokonte motorrinon. ... Mjetin e kam blerë për një milion lekë, tek një person që quhej ***, si kujtoj mbiemrin, para tre ditësh, dhe po e mbaja edhe për provë. Këtë mjet e përdorja unë, por e*

përdornin edhe pjesëtarë të tjerë të familjes time. ... Sqaroj se mjete ka qenë me dokumentet origjinale në gjuhën belge, por që unë nuk i disponoj, pasi ato më janë vjedhur së bashku me mjetin. Për këtë, unë nuk kam kujtesë së çfarë ishin konkretisht”.

16.5.2 Nga sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka paguar një shtetasi të panjohur nga ana e tij, të takuar në mënyrë rastësore, në një lavazh, një vlerë monetare prej një milion lekësh, për të marrë në përdorim një makinë në gjendje jo të mirë dhe me targa të huaja, pra pa dokumentacionin përkatës. Përkundrejt deklarimeve të subjektit se mjete ishte marrë për provë, nga materiali kallëzues, rezulton se subjekti, në cilësinë e pronarit, për aq pak ditë, ka investuar duke instaluar dhe një sistem alarmi, i cili siguronte dyert dhe bllokonte motorrinon, si dhe këtë mjet e përdornin dhe familjarët e tij.

16.5.3 Sa më sipër, referuar gjendjes në të cilën janë aktet, më së paku, duket se ka qenë një qasje e pakujdesshme e subjektit të rivlerësimit, marrja/ blerja e një mjeti të një shtetasi, të cilin e ka të vështirë për ta identifikuar, në kushtet e mungesës së dokumentimit të transaksionit të kryer.

16.5.4 Subjekti nuk ka deklaruar në Deklaratën periodike të interesave vjetore të vitit 2008, blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, vlerën dhe as burimin e krijimit të kësaj shume.

16.5.5 Lidhur me shtetasin ***.***, subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se *aty i pranishëm ishte dhe shtetasi ***.***, po lante mjetin dhe dëgjoji bisedën, më pa e pashë dhe asgjë tjetër.* Në dosje të Komisionit, lidhur me shtetasin ***.***, ndër të tjera, gjendet e administruar shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me nr.**.*** prot., datë **.1.2008, drejtuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, e cila, ndër të tjera, ka informuar se: [...] *Nga ana jonë është identifikuar shtetasi ***.***, ...banues në Tiranë, banesë 3-katëshe në afërsi të sheshit “***”, ish-***.***. Në ngarkim të shtetasit ***.***. ka të dhëna për aktivitete kriminale në fushën e trafikut të mjeteve motorike, si dhe trafik e shpërndarje të lëndëve narkotike. Shtetasi ***.***. është administrator i një pikë shitje materiale alumini dhe një lavazh në afërsi të banesës së tij [...].*

16.6 Sa i përket çështjes penale që subjekti i rivlerësimit ka hetuar me shtetasin ***.***, referuar akteve të procedimit penal nr.**.***, të vitit 2006, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialit referues të ardhur nga Komisariati i Policisë nr. 3, Tiranë, mbi ngjarje të datës **.5.2006. Policia ka referuar ngjarjen për veprat penale të “Vrasjes me dashje të mbetur në tentativë”, “Prishjes së qetësisë publike, “Vetëgjyqësia” dhe “Mbajtje pa leje të armëve të gjahut”.

16.7 Ky procedim, me vendimin e datës **.5.2006, të zv.prokurorit të Rrethit, z. ***.***, është regjistruar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***, dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit ***.***. Për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar subjekti i rivlerësimit.

16.8 Me vendimin e datës **.8.2006, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: *“Mbi pushimin e hetimeve të procedimit penal nr.**.***, i vitit 2006”, mbështetur në nenin 328/1, germa “c” dhe 19 të K. Pr. Penale. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: nuk rezulton se shtetasi ***.***. të ketë konsumuar elementet të kundërvajtjes penale të “Vetëgjyqësisë”, ndërsa për shtetasin ***.***. ka arsyetuar se ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, neni 19 i Kodit Penal.*

16.9 Nga aktet në fashikull, nuk duket i arsyetuar pushimi i veprës penale “Vetëgjyqësi”, për shtetasin ***.***., ndërkohë që gjenden të administruara dhe dy ekspertiza mjeko-ligjore, të cilat i referohen dëmtimeve të marra nga shtetasit në konflikt, nga ato që kanë sjellë për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë pushim, nr. ***, datë **.5.2006, për ekzaminimin e shtetasit ***.***., dhe nr. ***, datë **.5.2006, për ekzaminimin e shtetasit ***.***.

16.10 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ mbi këtë pasuri/mjet, deklaratimet kontradiktore, çështjet e pahetuara mbi rrethanat e vjedhjes së mjetit¹², shtetasit e përfshirë në transaksionin e blerjes, të cilat mbesin në nivel deklarativ, mungesa e arsytimit ligjor në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***/2006, shfaqin qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit, dhe janë elemente të cilat duhen vlerësuar nga Kolegji, në drejtim të parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. Transaksione bankare të kryera nga personi i lidhur *.***. (***)**

17.1 Komisioneri Publik, duke i konsideruar të mjaftueshme gjetjet e referuara më sipër, për të arritur një konkluzion mbi nivelin e besueshmërisë të subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e pasurisë, paraqet para Kolegjit dhe disa rrethana, të cilat, në vlerësimin e Komisionerit Publik, paraqesin elemente që mund të merren në konsideratë nga Kolegji, në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me kriterin e pasurisë, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

17.2 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se personi i lidhur, znj. ***.***. (***), gjatë periudhës 2004–2006, ka depozituar në llogaritë bankare të babait të subjektit, në *** Bank, në total, shumat 1.905.068 lekë, 29.210 euro dhe rreth 3.000 USD.

17.2.1 Komisioni, pas riçeljes së hetimit administrativ, ka vendosur të shtrijë hetimin dhe të kryejë një analizë financiare lidhur me depozitimet e kryera nga bashkëjetuesja e subjektit, në llogaritë e babait të subjektit të rivlerësimit, dhe në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi: *Duket se ju nuk keni shpjeguar dhe provuar bindshëm burimin e krijimit të këtyre likuiditeteve, që depozitohen në mënyrë periodike nga bashkëjetuesja/bashkëshortja juaj, znj. ***.***. /***., pasi duket se këto transaksione janë pasuri e fshehur nga ana juaj.*

17.2.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar se shtetasja ***.***. ka vepruar me tagrin “depozitime për të tretë”. Ajo nuk ka të drejta në llogarinë e babait të tij, por vetëm ka kryer depozitime për të lehtësuar veprimin bankar, për shkak të punës së saj (si punonjëse banke). Këto arkëtime nuk janë as hua, as dhurim. Burimi i krijimit të shumave të depozituara janë të ardhurat e babait dhe familjes së tij ndër vite.

17.3 Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit, ***.***. (***), ka kryer depozitime dhe tërheqje të vazhdueshme në llogaritë e saj bankare në *** Bank, në monedhat lekë dhe euro.

17.3.1 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këto transaksione, në përgjigjet e Pyetësorit nr. 3, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Në llogaritë e saj ka kryer veprime*

¹² Nga fashikulli nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime hetimore për këtë kallëzim. Në lidhje me këtë konstatim, rezulton se Komisioni i ka kaluar barrë prove dhe kërkuar shpjegime dhe një subjekti tjetër rivlerësimi, z.***.***., që rezulton të ketë qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes. Referohuni vendimit të publikuar në faqen zyrtare, nr. ***, datë **.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, f. 41 e tij.

*si për vete dhe për anëtarët e familjes, duke lehtësuar ata për veprimet e tyre në bankë. Burimi i krijimit të arkëttimeve të kryera janë nga pagat dhe të ardhurat e familjarëve të saj. Në periudha të caktuara kohore, llogaria ka qenë e përbashkët me prindërit dhe motrën e saj. Theksoj se znj. ***, është bërë person i lidhur me mua pas lidhjes së martesës, në datën **.1.2010. Vlerësoj se përpara kësaj date, ajo nuk ka detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të lëvizjeve në llogarinë e saj. Për veprimet në llogari të bashkëshortes nga viti 2010 deri në vitin 2016 ne i kemi raportuar në deklaratimet vjetore [...].*

17.3.2 Në dosje të Komisionit është administruar edhe një procesverbal i mbajtur në ILDKPKI, në datën **.4.2016, ku, ndër të tjera, subjekti, i pyetur lidhur me një depozitim në llogarinë e bashkëshortes, në shumën 1.095.000 lekë, në datën **.8.2010, ka deklaruar: [...]. *Kjo shumë ka pasur si burim kursimet personale të prindërve të b/shortes sime në vite dhe këto veprime i ka bërë b/shortja ime, për arsye se ata e kanë pasur të pamundur [...].*

17.3.3 Komisioni, meqenëse subjekti ka deklaruar në pyetësin standard se ka filluar të bashkëjetojë me znj. ***, prej vitit 2005, e ka konsideruar atë person të lidhur që prej kësaj periudhe (2005) dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të japë shpjegime për secilin transaksion, për burimin e krijimit të tyre si dhe për destinacionin e përdorimit të tyre.

17.3.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se znj. ***, nuk ka qenë person i lidhur me të përpara datës së lidhjes së martesës dhe, për këtë arsye, nuk ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e parave të depozituara prej saj në llogarinë bankare, si dhe ka deklaruar se veprimet janë kryer në llogarinë e përbashkët bankare të znj. ***, me familjaret e saj, dhe kursimet e vendosura në këtë llogari janë kursime të përbashkëta familjare.

17.4 Në përfundim, Komisioni, lidhur me këto transaksione, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të këtyre transaksioneve¹³.

17.5 Komisioneri Publik, pasi analizoi aktet e administruara në dosje të Komisionit, lidhur me këto transaksione, në raport dhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe pas kalimit të barrës së provës, vëren se disa prej këtyre transaksioneve, për të cilat është pyetur subjekti, janë kryer gjatë vitit 2010, pas martesës ligjore të subjektit të rivlerësimit me znj. ***. Konkretisht: (i) Në datën **.2.2010 është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. ***, në *** Bank, shuma 9.000 euro. Kjo shumë është tërhequr po *cash* në datën **.3.2010. (ii) Në datën **.8.2010 është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. ***, pranë *** Bank, shuma 1.095.000 lekë, e cila është tërhequr një ditë më pas.

17.5.1 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, si dhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën **.4.2016, ka deklaruar se burimi i këtyre shumave janë kursimet e familjes së bashkëshortes.

17.5.2 Nga analizimi në tërësi i transaksioneve të kryera në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit dhe babait të subjektit të rivlerësimit, duket se, më së paku, depozitimi i këtyre shumave në llogarinë e personit të lidhur, në *** Bank, korrespondon me tërheqjen e të njëjtave

¹³ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 40 të vendimit.

shuma, në të njëjtën datë, nga llogaria bankare e babait të subjektit, në *** Bank, çka bie ndesh me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

III.B. Lidhur me vlerësimin e figurës dhe gjetjet në raportin e DSIK-së

18. Gjatë hetimit për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka përcjellë pranë Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë **.9.2022, Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin informohet se: [...] *Gjatë periudhës në të cilën z. Bejko ushtronte detyrën si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Durrës, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive *****. Institucionet verifikuese i kanë përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm materialin ku, ndër të tjera, thuhet se: “***** në bashkëpunim me prokurorin Bledar Bejko kanë lehtësuar pozitën e të pandehurve, duke ndryshuar cilësimin e veprës penale kundrejt mitës, në vlerën prej *****”. ... Në përfundim, grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Bledar *** Bejko [...].*

19. Komisioni, në vijim të informacioneve të DSIK-së, ka administruar fashikullin penal, që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën **.4.2017, në ngarkim të të pandehurit ***.***., akuzuar për veprën penale “*Vrasje nga pakujdesia*”, parashikuar nga neni 85 i K. Penal.

20. Nga aktet rezulton se kjo çështje është vënë në vëmendje të Komisionit dhe nga denoncime të përsëritura të shtetases ***.***., e cila ngre pretendime mbi vendimet e subjektit për pushimin e procedimit, kualifikimin e veprës penale nga subjekti i rivlerësimit,¹⁴ si dhe mungesën e njoftimit mbi ecurinë e procedimit penal. Kjo shtetase, ndër të tjera, pretendon se personat që i vranë bashkëshortin, janë lënë të lirë, si shtetasi ***.***., i vjehri ***.***., dhe vëllai i tij, shtetasi ***.***., si dhe pretendon se nuk është njoftuar mbi vendimin e pushimit të procedimit penal për njërin nga këta shtetas, duke mos i mundësuar të drejtën e ankimit.

21. Po për këtë çështje, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me shkresën nr.***/* prot., datë **.12.2021, ka informuar Komisionin se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. ***, viti 2019, nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda, Tiranë. Pas kryerjes së verifikimeve lidhur me këtë kallëzim, është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal/*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*.

21.1 Pas kryerjes së hetimeve të këtij procedimi është vendosur dërgimi për kompetencë pranë SPAK, duke u regjistruar kështu procedimi me nr.***, datë **.12.2019. Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me vendimin nr. ***, datë **.10.2020, ka vendosur pushimin e çështjes. Në vendimin e pushimit të çështjes, ku referohet dhe informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese, ndër të tjera, Gjykata arsyeton se: [...] *Gjykata e çmon të drejtë vlerësimin e prokurorit se kjo kohë e gjatë e kaluar nuk lë hapësira për të kryer veprime proaktive në kohë reale, për të zbardhur ekzistencën e një fakti të tillë penal [...].*

¹⁴ Denoncuesja pretendon se nuk mund të ketë vrasje nga pakujdesia, kur të tre kriminelët hynë në dyqanin tonë, mbyllën qepenat dhe me mjete të forta e goditën bashkëshortin për vdekje. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit, në cilësimin e prokurorit të çështjes, bëri vendim pushimi mbas 3 muajve dhe i dha pafajësinë.

22. Komisioneri Publik, nga analizimi i akteve të administruara, si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese dhe pretendimeve të denoncueses, konstaton rrethanat sa në vijim:

23. Procedimi penal nr. ***, datë **.4.2017

23.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Durrës, në datën **.4.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, bazuar mbi aktet e para të dërguara me shkresën nr. ***, datë **.4.2017, nga Drejtoria e Policisë Vendore Durrës, regjistruar për veprën penale “*Vrasja, kryer në bashkëpunim*”, parashikuar nga nenet 76-25 të K. Penal.

23.2 Në datën **.4.2017, në lagjen nr.***, rruga “**** ***”, Durrës, në brendësi të dyqanit supermarket, ku tregtohen artikuj të ndryshëm të përzier, në pronësi të shtetasit ***.***., shtetasit e dyshuar ***.***. dhe ***.***., vëllezër, janë përfshirë në një konflikt fizik, duke goditur të dy me grushte dhe me mjete të forta shtetasin ***.***. Si rezultat i dhunës fizike, ky shtetas ka mbetur i dëmtuar rëndë dhe ka gjetur vdekjen në vend¹⁵. Shtetasit ***.***. (vëllezër) janë arrestuar në kushtet e flagrancës.

23.3 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.4.2017, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, caktimin e masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*”, pasi ishin verifikuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktim të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj tyre, parashikuar në nenet 228, 229, 230, 238 dhe 258 të K. Pr. Penale¹⁶.

23.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. *** dhe nr.***, datë **.4.2017¹⁷, ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin e dy shtetasve ***.***., ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *veprat penale për të cilën akuzohen të dyshuarit përbëjnë krim të rrezikshëm dhe është mjaft i përhapur në Shqipëri. Për këtë vepër, legjislacioni parashikon dënim me burgim nga 10 deri në 20 vjet. Në rastin konkret ekzistojnë kushte dhe kritere për caktimin e masës së sigurimit, atë të “Arrestit me burg”, konkretisht ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova se shtetasit ***.***. kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 76 dhe 25 i K. Penal [...].*

23.5 Për një periudhë 3-mujore, deri në datën **.7.2017, dy shtetasit e mësipërm janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit, si autorë të dyshuar të kryerjes së veprës penale të “*Vrasje e kryer me dashje në bashkëpunim*”, të parashikuar nga nenet 76-25 të K. Penal.

23.6 Më datë **.7.2017 (pa hyrë në fuqi ndryshimet e reja ligjore), subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] *duke mbajtur parasysht*

¹⁵ Vërtetim lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës nr. *** prot. (B. B.), datë **.4.2017.

¹⁶ Në kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, theksohet se është fiksuar si provë materiale një thikë, duke detajuar edhe përmasat e saj, si dhe njolla e gjakut. Është përpiluar procesverbali mbi këqyrjen dhe marrjen e provave, janë përpiluar vendimet e ekspertimit biologjik, vlerësues të provës materiale, vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik të thikës, vendimi për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik, vlerësues të provës. Në referim cilësohet se është përpiluar vendimi për sekuestrimin e provës, njësia e kamerave të një lokali, procesverbali mbi këqyrjen e kufomës së viktimës ***.***., vendimi i ekspertimit toksikologjik etj. Janë pyetur si persona që tregojnë rrethanat e hetimit disa shtetas, mes tyre edhe shtetasit ***.***. dhe ***.***. Është përpiluar procesverbali mbi sekuestrimin e një CD me pamje filmike, të dorëzuar nga shtetasi ***.***. Është përpiluar vendimi për sekuestrimin e provës materiale, provë e cila është njësia e kamerave të një lokali “**** ***”. Nga pamjet filmike, të marra jashtë lokalit rezultoi se në lokal kanë hyrë fillimisht i dyshuari ***.***. dhe më pas i dyshuari ***.***. dhe njëkohësisht edhe shtetasi ***.***. ka hyrë dhe dalë disa herë brenda lokalit. Pas 3-4 minutash dalin edhe dy të dyshuarit, të cilët qëndrojnë më pas në rrugë.

¹⁷ Vendimi nr. ***/2017 i përket shtetasit ***.*** dhe vendimi nr. ***/2017, shtetasit ***.***. Ndaj vendimit të Gjykatës, më datë **.4.2017, është paraqitur ankim nga dy shtetasit ***.***., si dhe, më datë **.5.2017, është paraqitur apel kundërshtues nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për masën e sigurisë “Arrest me burg”.

rrethanat e faktit, konstatohet se nuk ka asnjë provë që të provojë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i dyshuari ***.***. të ketë konsumuar figurën e veprës penale për të cilën dyshohet. Në këto kushte, akuza ndaj tij mbetet në kuadrin e dyshimit, për sa kohë që nuk rezulton asnjë provë tjetër për të vërtetuar këtë dhe, në këtë rast, dyshimi shkon në favor të të pandehurit [...], ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të të pandehurit ***.***., dhe shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest me burg”, dhe lirim të menjëhershëm të tij nga IEVP Durrës. Me këtë vendim të njoh personat e interesuar.

23.7 Më datë **7.2017¹⁸, subjekti i rivlerësimit i ka njoftuar shtetasit tjetër, ***.***., akuzën për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i K. Penal. Në vijim, subjekti, më datë **7.2017, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke arsyetuar se: [...] Nga tërësia e akteve hetimore të çështjes penale të mësipërme janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme dhe janë mbledhur prova që tregojnë fajësinë e të pandehurit për veprën penale që është akuzuar [...].

23.8 Komisioni ka konstatuar se, kundër vendimit të pushimit për shtetasin ***.***., nuk është ushtruar ankimi, vendim ky i barazuar me vendim të formës së prerë.¹⁹ Nga verifikimi i akteve në dosje, nuk rezulton se vendimi i pushimit, i datës **7.2017, t’iu jetë komunikuar palëve të interesuara, në përputhje me dispozitat procedurale penale, duke i mohuar të drejtën thelbësore për ushtrimin e ankimit. Si pasojë e mosushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi, vendimi i pushimit ka marrë formë të prerë, duke u barazuar me vendimin e pafajësisë ndaj shtetasit ***.***. Si pasojë e vendimit të formës së prerë të pafajësisë, gjykata më tej nuk ka pasur kompetencë për të marrë të pandehur shtetasin ***.***. dhe, për pasojë, ka rënë akuza e bashkëpunimit.

23.9 Komisioni, për sa më sipër, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me: [...] Pretendimin e denoncueses dhe konstatimin e Komisionit (gjithnjë sipas akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ) për mosnjoftimin e vendimit të pushimit të çështjes për të akuzuarin ***.***., trashëgimtarëve të viktimës, në kundërshtim me nenin 134 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të depozitoni dokumentacionin mbështetës nga fashikulli i çështjes, për të provuar të kundërtën e rezultatit. Qartësoni se cili është statusi aktual i vendimit gjyqësor nr.***, datë **12.2017 [...].

23.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] Bazuar në neni 328, 329, të Kodit të Pr. Penale (përpara ndryshimeve të këtij Kodi me ligjin nr.35/2017), prokurori kishte të drejtë të pushonte çështjen ose akuzën. Në ligj nuk parashikohet si subjekt procedural trashëgimtari i viktimës. Në kushtet kur çështja është regjistruar kryesisht (pra s’kishte kallëzues), ligji nuk parashikonte detyrimin e prokurorit të njoftonte trashëgimtarët e viktimës. Pavarësisht sa më sipër rezulton e provuar se kallëzuesja ka marrë gjithë aktet e dosjes. ... Kjo shtetase ka paraqitur disa ankime ndaj vendimit të pushimit në Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtuesit të Prokurorisë, ka marrë pjesë në gjykim me avokat ***.***., është pyetur si dëshmitare etj. ... Kjo shtetase pretendon se i është mohuar e drejta e ankimit, të drejtë të cilën ajo nuk e ka ushtruar asnjëherë. Theksojmë, edhe një herë, që ajo ka pasur të drejtë në çdo moment të paraqiste ankim ndaj vendimit të pushimit, e palimituar në kohë nga momenti që ka marrë dijeni e në vazhdim, dhe është marrë me ankesa, pa kryer një ankim të mirëfilltë procedural. ... Bazuar në vendimet gjyqësore, bie poshtë çdo

¹⁸ Data e referuar në aktin për njoftimin e akuzës.

¹⁹ Komisioni i është referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, sipas vendimit nr.126, datë 22.6.2016.

*pretendim se vrasja është kryer në bashkëpunim, për shkak se nuk mund të ketë bashkëpunim për veprat penale të kryera nga pakujdesia [...]. Subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve Vendimin e Gjykatës së Apelit, Durrës, numër **-2018-*** (***) , datë **.6.2018.*

23.11 Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me vendimin nr. *** (**-2017-***), datë **.12.2017, ka vendosur: [...] *Deklarimin fajtor të të pandehurit ***.***, për kryerjen e veprës penale: “Vrasje nga pakujdesia”, të parashikuar nga neni 85 i K. Penal, dhe dënimit e tij me 5 vjet burgim [...]. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i pandehuri ***.***, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes në ngarkim të tij, me pretendimin se fakti nuk përbën veprë penale, ose caktimin e një mase dënimi më të butë ndaj tij, duke u aplikuar gjykimi i shkurtuar, parashikuar nga nenet 403 dhe 404 të K. Pr. Penale.*

23.12 Në përshkrimin e rrethanave të ngjarjes, Gjykata e Apelit ka referuar se, kundër vendimit të subjektit të rivlerësimit, të datës **.7.2017, “Për pushimin e hetimeve dhe lirimim e menjëhershëm të të dyshuarit ***.***.”, me shkakun se nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale, nuk është ushtruar ankim dhe, në këto kushte, sipas edhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, vendimi i pushimit kur merr formë të prerë, barazohet me vendimin e pafajësisë (referuar vendimit nr.126, datë 22.6.2016, të K. P. Gj. L.).

23.13 Lidhur me ankimin e ushtruar nga i pandehuri tjetër, ***.***, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. **, datë **.6.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, me këtë ndryshim: [...] *Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale, uljen 1/3 të dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim [...].*

23.13.1 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar: [...] *Në të tilla kushte, trupi gjykues, pas një hetimi të zgjeruar, në raport me legjislacionin, veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, vendimet e dhëna nga gjykatat ndaj subjektit lidhur me kallëzimet e bëra nga shtetasja ***.***, përfshirë dhe statusin ligjor të vendimmarrjes, i kontrolluar dhe nga një gjykatë më e lartë, duket se nuk konstaton problematika që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit [...].*

24. Komisioneri Publik, nga vendimi i Komisionit, paraprakisht, vëren se çështjet e hetuara si rezultat i informacioneve të DSIK-së, janë vlerësuar të lidhura me kriterin profesional dhe janë pasqyruar nga Komisioni, në seksionin e kriterit profesional nën titullin: “Gjetje të tjera”, pasi, lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Bejko, ka arritur një nivel të besueshëm dhe, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, ka konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

25. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, çmon se rastet e referuara në Raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për përfshirje në veprime korruptive, paraqesin rrethana të ndryshme nga ato të verifikimit të aftësive profesionale të subjektit. Në këtë kontekst, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, është e pamundur që, në kuadër të vlerësimit të figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale.²⁰

²⁰ Referuar vendimit (JR) nr. 20/2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku, ndër të tjera, në prg. 34.3, ka arsyetuar: [...] *Kolegji vlerëson se, pavarësisht se u është dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura nga subjekti në ankim, këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në Raportin e DSIK-së rezulton se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë kontekst është e pamundur që, në kuadër të vlerësimit të figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë*

26. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se të dhënat e administruara nga organet ligjzbatuese duhen analizuar në raport dhe me gjetjet e tjera të rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, nëse në to ka elemente që duhen trajtuar si situata, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pa i nxjerrë nga kriteri i kontrollit të figurës.

27. Sa më sipër, Komisioneri Publik, për sa është administruar në dosje të Komisionit, në analizë të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë procedimit penal nr.***/2017, konstaton se mungon njoftimi i të dëmtuarës, shtetases ***.***., *për pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit ***.***.* Mosushtrimi i ankimit, ashtu sikurse ka arsyetuar dhe Gjykata e Apelit Durrës, duket se ka sjellë si pasojë barazimin me vendimin e pafajësisë. Në rastin konkret vlerësojmë se nuk qëndrojnë parashtrimet e subjektit, ku arsyetohet se jemi para rastit të *mungesës së parashikimeve ligjore të njoftimit të trashëgimtarëve të viktimës.*

28. Neni 329 i K. Pr. Penale, i pandryshuar me ligjin nr. 35/2017, në pikën 1 të tij, parashikonte se, kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes, mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor *i dëmtuari dhe i pandehuri.* Në vendimin e datës **4.2017, *për pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit ***.***., të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, parashikohet se ky vendim duhet t'i njoftohet palëve të interesuara.* Përtej pretendimeve të subjektit, se shtetasja ***.***., për shkak të rrethanave, duhej të kishte dijeni, mbetet e faktuar se subjekti nuk rezulton të ketë kryer njoftime mbi vendimin e pushimit, sipas parashikimeve ligjore.

29. Komisioneri Publik, në rrethanat kur interesimi dhe përfshirja e shtetasës ***.***. ishte më shumë se në cilësinë e personit të interesuar, pasi kjo shtetase kishte njoftuar policinë për ngjarjen, ka qenë e pranishme në konfliktin me të dyshuarit, ku si pasojë kishte humbur jetën dhe bashkëshorti i saj, ka shfaqur në mënyrë të vazhdueshme interesin për çështjen dhe ecurinë e procedimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore ta njoftonte, për më tepër, kur në konfliktin në të cilin ishin përfshirë më shumë se dy persona, më së paku, dy prej tyre janë hetuar *për vrasje në bashkëpunim.* Me vendimin e pushimit të procedimit penal për një nga të pandehurit dhe si rezultat i ndryshimit të cilësimit të veprës penale, ashtu sikurse dhe subjekti është shprehur, *ka rënë poshtë çdo pretendim se vrasja është kryer në bashkëpunim, për shkak se nuk mund të ketë bashkëpunim për veprat penale të kryera nga pakujdesia.*

30. Në përfundim për kontrollin e kriterit të figurës, Komisioneri Publik vlerëson se nga të dhënat e administruara si rezultat i *informacioneve të organeve ligjzbatuese,* duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret, mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësisë profesionale [...].

III. C. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale

31. Komisioni, pas vlerësimit të burimeve mbi aftësitë profesionale, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a” të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, dhe për këtë shkak konsiderohet i “aftë”.

32. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me gjetjet e konstatuara në vlerësimin e këtij kriteri dhe parashtron për shqyrtim para Kolegjit, çështjet si në vijim:

33. Procedimi penal nr. */2017, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të dyshuar, Komisar ***.***. me detyrë shef i stacionit të Policisë Plazh dhe nënkomisar ***.***., me detyrë OPGJ²¹**

33.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në informacionin e përcjellë nga SHÇBA në Drejtorinë e Policisë Vendore Durrës, ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë **.10.2017, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj personit nën hetim, shtetasit ***.***.²², i cili, në kundërshtim me detyrën, ka përgatitur Vërtetimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë për shtetasin ***.***. (për dhënie të armës së zjarrit për në banesë), ndërkohë që SHÇBA-ja ka pasur informacione se ky shtetas ka qenë person me precedent penal.

33.2 Nga hetimi i Komisionit²³ ka rezultuar se, fillimisht, subjekti i rivlerësimit, në datën **.10.2017, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” ndaj shtetasit ***.***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me vendimin e saj nr. ***, datë **.10.2017, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të këtij shtetasi dhe caktimin e masës shtrënguese “Arrest në shtëpi” ndaj personit nën hetim, ***.***., sipas kërkesës së organit të Prokurorisë në seancë gjyqësore.

33.3 Në datën **.1.2018, subjekti ka vendosur zgjatjen e hetimeve deri në datën **.4.2018, duke kryer disa veprime hetimore²⁴. Në datën **.2.2018, drejtuesja e Prokurorisë ka udhëzuar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore ndaj shtetasve nën hetim²⁵.

33.4 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer pjesërisht veprimet hetimore të udhëzuara nga drejtuesja e Prokurorisë dhe duket se nuk janë kryer hetimet e tjera, si ripyetja e shtetasit ***.***., për caktimin e tij për ndjekjen e praktikës për vërtetimin e besueshmërisë, mosadministrimi i certifikatës së gjendjes civile me pasqyrimin e ndryshimit të emrit të shtetasit ***.***., si dhe ballafaqimi mes dy punonjësve, epror/specialist.

²¹ Në vendimin e Komisionit, kjo çështje është trajtuar në rubrikën “Gjetje të tjera”, f. 59-63.

²² Më **.10.2017 është nxjerrë urdhri për regjistrimin e personit në procedimin penal, shtetasi ***.***.

²³ Referohuni f. 59 të rezultateve të hetimit dhe f. 60 në vendimin e Komisionit.

²⁴ Në zgjatjen e afateve është kërkuar marrja e dosjes penale e vitit 2011 për shtetasin ***.***., pyetja e OPGJ-së që ka kryer hetimet me këtë dosje, administrimi i dëshmisë së penaltetit për shtetasin ***.***. etj.

²⁵ Referuar rezultateve të hetimit f. 60, drejtuesja e Prokurorisë ka udhëzuar mbi: (i) kërkimin e dokumentacionit për të verifikuar nëse qëndronte pretendimi i shtetasit ***.*** si epror, se nuk kishte nënshkruar vërtetimin e besueshmërisë, për shkak se në periudhën e lëshimit kishte qenë në trajnim; (ii) ballafaqimin midis dy shtetasve, ***.*** dhe ***.***, nën pretendimin e shtetasit ***.*** se vërtetimin mund ta ketë nënshkruar shtetasi ***.***; (iii) verifikimin e faktit se shtetasi ***.*** ka ndryshuar emrin e tij dy herë, përkatësisht në vitin 2009 dhe 2010, dhe përse nuk është administruar certifikata në lidhje me ndryshimet e emrit, dhe për këtë të ripyetet shtetasi ***.***; ky i fundit të ripyetet në lidhje me pretendimin për nënshkrimin në emër të shtetasit ***.***, si dhe të kryhet Akti i ekspertimit teknik grafik i shkrimit, nëse nënshkrimi në praktikë është i shtetasit ***.*** ose jo, si dhe të kryhet verifikimi se si është caktuar ***.*** për ndjekjen e kësaj praktike, kur në kartelën shoqëruese është sigluar nga komisar ***.*** një tjetër punonjës.

33.5 Nga aktet rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me vendimin e saj nr. ***, datë **.5.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës së datës **.3.2018 dhe pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***/2017, në ngarkim të këtyre shtetasve, ***.***. dhe ***.***., të akuzuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë më datë **.5.2018.

33.6 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me arsyet e ndryshimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit në kërkimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit ***.***., nga *arrest me burg*, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, të datës **.10.2017, në *arrest në shtëpi*, në seancën gjyqësore të datës **.10.2017. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore të lëna detyrë nga eprori.

33.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në seancën e vlerësimit të masës së sigurimit, kam kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”, pasi masa arrest në burg nuk i përgjigjej më nevojave të sigurimit. Mbi bazë të informacioneve verifikuese që u disponuan në mënyrë të shpejtë, në momentin që Gjykata mori në shqyrtim kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, ra niveli i provueshmërisë së dyshimit të arsyeshëm mbi ekzistencën e faktit penal... Lidhur me detyrat e lëna nga eprori, si ripyetja e shtetasit *** dhe ballafaqim i dy punonjësve të policisë, kryerja e tyre është parë si e panevojshme. Bazuar në ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale, udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë nuk janë detyruese. Është në vlerësim të prokurorit të çështjes të çmojë përfundimisht kryerjen ose jo të këtyre detyrave. Kam vlerësuar se nga aktet e administruara, rrethanat e faktit ishin të qarta dhe ripyetja apo ballafaqimi i personave ishte i panevojshëm, për shkak se të gjitha faktet ishin sqaruar [...].*

33.8 Në përfundim, Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve, të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Argumentet e parashtruara nga subjekti lidhur me kërkimin e ndryshimit të masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit *** ***, të cilat kishin nxjerrë në pah problematikat shëndetësore, familjare dhe ekonomike të tij, duken të pranueshme në raport me të dhënat e para, të cilat nuk mund të jenë gjithnjë prezent në kushtet e ngutshmërisë që kërkohet për të vendosur mbi caktimin e një mase sigurimi personal ndaj një personi.... Në të tilla kushte duket se janë grumbulluar disa prova, të cilat, pa mënjeluar edhe vlerësimin e bindjes së brendshme të subjektit, përpos edhe logjikës së përdorur në arsyetimin e kërkimit të tij ndaj organeve gjyqësore, e cila nuk mund të zëvendësohet dhe as interpretohet, përfshirë këtu edhe vendimmarrjet e gjykatave, së bashku krijojnë një panoramë të plotë e të qartë, për të cilën trupi gjykues duket se nuk konstaton problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit [...].*

33.9 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se në rastin konkret duket se në aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit mungon arsyetimi ligjor mbi informacionet verifikuese të disponuara në mënyrë të shpejtë, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, diktuan ndryshimin e kërkimit të masës së sigurimit personal nga “Arrest me burg”, në “Arrest në shtëpi”, ndaj shtetasit ***.***. Gjithashtu, duket se mungon argumentimi i subjektit të rivlerësimit mbi trajtimin si të panevojshme të disa prej veprimeve hetimore të udhëzuara nga prokurori epror²⁶. Fakti që udhëzimet nuk janë të detyrueshme për prokurorët,

²⁶ Neni 48/5 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

nuk nënkupton që subjekti i rivlerësimit të mos ushtrrojë kompetencat që i njeh ligji në drejtim të eficiencës së këtyre hetimeve.

33.10 Nga aktet e administruara, duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

34. Denoncim²⁷ i shtetasit * ***(**.*.**.)**

34.1 Shtetasi **.*.**. i është drejtuar Komisionit, duke parashtruar se: *prokurori Bledar Bejko nuk ka kryer veprime hetimore sipas ligjit, ka vendosur padrejtësisht pushimin e procedimit, të cilin e ka rrëzuar Gjykata në dy shkallët e gjykimit. Gjykata vendosi rifillimin e hetimeve dhe ky prokuror ka afërsisht një vit që nuk kryen asnjë veprim hetimor dhe zvarrit procesin, ndërkohë që unë ndihem i rrezikuar, sepse kërcënohem nga personi i kallëzuar në Prokurori. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit disa dokumente.*

34.2 Në kallëzimin penal të administruar (datë **.7.2017) referohet se shtetasi **.*.**. ka një kontratë huaje me shtetasin **.*.**., për vlerën 2.200 euro, fakt ky i vërtetuar me kontratën e huas nr.*** rep. ***/* kol., datë **.10.2014. Shtetasi **.*.**., ndër të tjera, parashtron se, *pavarësisht se detyrimi është shlyer, shtetasi **.*.**. dhe shtetasi **.*.**. kanë vazhduar të kërkojnë para, duke kërkuar në mënyrë ultimative para të kartëmonedhave euro, duke më vënë në kushte se, përveç pasurisë së vendosur si barrë hipotekore për shlyerjen e huas (tashmë të shlyer) kërkon edhe para të tjera në formën cash. Nga ana tjetër, i kallëzuarit, në mënyrë të vazhdueshme me telefonon, në numrin tim celular, duke më kërkuar që të vazhdojë të bëjë pagesa për llogari të tij.*

34.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, me shkresën nr.*** prot. (B. Bejko), datë **.9.2017, me objekt: “Dërgojmë vendimin e mosfillimit nr.***, viti 2017”, i ka përcjellë shtetasit **.*.**. një kopje të vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. ***/2017. Në vendimin e datës **. 9.2017, mbi mosfillimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit, pasi ka parashtruar rrethanat dhe konstatimet,²⁸ ka arsyetuar se: [...] *Nga sa më sipër vërehet se marrëdhënia midis **.*.**. dhe **.*.**., babai i të kallëzuarit **.*.**., ka lindur për shkak të kontratës së huas nr. *** rep./***/* kol., datë **.10.2014, nga e cila rrjedhin të drejta dhe detyrime. Pretendimet e kallëzuesit mund të realizohen nëpërmjet proceseve civile, që kanë të bëjnë me mospërmbushjen e detyrimeve të kontratës... Meqenëse ky fakt nuk është penal, mbështetur edhe në nenet 290/1 “c” dhe 291/1,2 të K. Pr. Penale; vendosa mosfillimin e hetimeve të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2017. [...]*

34.4 Nga aktet rezulton se kallëzuesi, shtetasi **.*.**., ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, prishjen e vendimit të Prokurorisë Durrës, të datës **.9.2017, mbi mosfillimin e hetimeve dhe urdhërimin e organit të akuzës të regjistrojë procedimin penal dhe të kallëzuarin si autor i tij, të bëjë hetime, ngrëjë akuza dhe të dërgojë çështjen në gjykim për veprën penale për të cilën është bërë kallëzimi.

²⁷ Protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë **.8.2018.

²⁸ Rezulton se më datë **.9.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku është pyetur shtetasi **.*.**.

34.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, me vendimin nr.**-2017-***, datë **.10.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Durrës, të datës **.9.2017, “Për mosfillimin e hetimeve”, për materialin kallëzues të ankuesit ***.***., regjistruar me nr.***, datë **.7.2017. Ndër të tjera, Gjykata ka arsyetuar se: [...] *Nga shqyrtimi i çështjes penale, del se gjatë fazës së verifikimit të kallëzimit penal të bërë, është pyetur në mënyrë të përciptë ankuesi ***.***., si dhe janë marrë deklaratimet e shtetasit ***.***. dhe ***.***. Rezulton se nuk është kryer asnjë veprim verifikues rreth pretendimeve të bëra në kallëzimin penal nga ana e ankuesit ***.***., si dhe të provave shkresore të paraqitura prej tij, dhe në këtë gjendje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Durrës është marrë vendimi i datës **.9.2017, “Mbi mosfillimin e hetimeve”, për kallëzimin penal nr.***, datë **.7.2017, që është kundërshtuar në Gjykatë nga ankuesi ***.***., duke kërkuar anulimin e tij dhe detyrimin e organit të akuzës të kryejë hetimet përkatëse. Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe konkludon se vendimi për mosfillimin e hetimeve të datës **.9.2017, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Durrës nuk është rezultat i verifikimit të kallëzimit penal të bërë nga ankuesi ***.***., dhe se duhet të kryhen një sërë veprimesh procedurale hetimore [...]. Gjykata në dispozitiv ka përcaktuar dhe detyrimet hetimore që duhet të kryhen.*

34.6 Subjekti i rivlerësimit ka apeluar vendimin gjyqësor nr. (***), datë **.10.2017, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *Ky vendim është kontradiktor dhe i pambështetur në ligj dhe prova, çka si i tillë duhet të priset, pasi: 1. Vetë ankuesi nuk shpjegoi me argumente se çfarë veprimesh nuk ishin kryer ose çfarë veprimesh duhej të ishin kryer nga organi procedues, kërkesë e ligjës. 2. Ankuesi pretendon se i ka dhënë 9 400 euro palës tjetër vetëm interes, pretendim ky i pabesueshëm dhe pa asnjë provë. 3. Ankuesi paraqiti si prova disa letra dore me shënimet e tij dhe llogari të bëra, që tregojnë detyrimet dhe një kontratë vëmendje, akte të njëanshme nga ai, dhe që nuk konfirmohen nga pala tjetër. 4. Këto pretendime ankuesi rezulton se i ka ngritur edhe në këtë proces penal, edhe me memo të veçantë, por nuk janë marrë parasysh si të pabaza. 5. Në këtë kuptim ndodhemi përpara faktit të llojit kontraktual civil [...].*

34.7 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë **.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë **.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka çmuar faktin se: “Vendimi për mosfillimin e procedimit penal i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës është i pabazuar në prova e ligj dhe, me të drejtë, është anuluar nga Gjykata e Shkallës së Parë, duke caktuar edhe kryerjen e disa veprimeve të domosdoshme procedurale. ... Rezulton se kallëzimi nga ankuesi/denoncuesi ***.***. është regjistruar në Prokurori në datën **.7.2017 dhe, në referim të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale, prokurori duhet të kishte vendosur mosfillimin e procedimit brenda datës **.8.2017 (Ndryshimet e K. Pr. Penale, ligji nr. 35/2017, kanë hyrë në fuqi më datë 1.8.2017). Në këtë kontekst, prokurori, jo vetëm që nuk ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, por, në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, më datë **.9.2017, ka kryer veprime hetimore, si pyetjen e deklaruesve ***.***. dhe ***.***., kur duhej të ishte shprehur me vendim brenda datës **.8.2017”. Më tej, Gjykata shprehet se: “Kryerja e veprimeve të mësipërme procedurale presupozon se kjo çështje de facto ka filluar dhe nga ana e Prokurorisë nuk duhej që të vendosej mosfillimi i procedimit, por pushimi i këtij procedimi penal konform nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale”.²⁹

²⁹ Gjithashtu, Gjykata e Apelit, në arsyetimin e saj ka cituar dhe vendimin unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

34.8 Nga aktet e administruara rezulton se denoncuesi, shtetasi ***. ***, në datën **.2.2018, duke cituar vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Durrës, i ka paraqitur drejtuesit të Prokurorisë Durrës, kërkesën për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, z. Bledar Bejko, duke parashtruar se: [...] *Në rrethana të tilla çmojmë se ka arsye serioze njëanshmërie nga ana e prokurorit Bledar Bejko, në arritjen e një konkluzioni tjetër mbi materialin kallëzues të depozituar ndaj meje në ngarkim të të kallëzuarve ***. dhe ***.**, rrethana këto të ballafaquara në dispozita të neneve 16 dhe 17 të K. Pr. Penale, duhet ta dërgojnë Drejtuesen e Prokurorisë Durrës në arritjen e konkluzionit se prokurori i çështjes, Bledar Bejko, duhet zëvendësuar [...].³⁰*

34.9 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, lidhur me: (i) *Duket se vendimmarrja për mosfillimin e procedimit penal, nuk është brenda afatit ligjor sipas parashikimit të bërë në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr.241, datë 21.11.2005, për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, apo edhe bazuar në nenin 290/1 të ligjit nr.35/2017, hyrë në fuqi më datë 1.8.2017. (ii) Qartësoni statusin aktual të kësaj çështje në përmbushje të detyrave të lëna nga Gjykata, si dhe depozitoni dokumentacionin provues.*

34.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në lidhje sa konstaton Komisioni, shpjegoj se në datën **.8.2017 (apo **.8.2017) si data limit brenda të cilit duhet të kisha marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, përfshihen në ditët e muajit gusht, kur Prokuroria dhe Gjykata ka të planifikuar lejet vjetore. Vendimin e mosfillimit e kam marrë bazuar në bindjen time të brendshme, menjëherë sapo jam kthyer nga leja vjetore. Bazuar në vendimin gjyqësor kam filluar hetimet dhe, bazuar në hetimet shtesë të kryera, kam konkluduar, në datën **.9.2020, se shtetasit ***.**, duhet t’i njoftohet akuza për veprën penale të “Mashtrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Më datë **.10.2020, çështja është dërguar për gjykim dhe vazhdon gjykimi me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Gjatë gjykimit është vendosur të kryhet një riekspertim, pasi akti i parë i ekspertimit grafik nuk e bindi Gjykatën se në dokumentet e dorëzuara nga kallëzuesi ndodhej shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasit ***.**,³¹ [...].*

34.11 Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konstatuar se: [...] *Periudha për dhënien e vendimit të mosfillimit i përkiste kohës në të cilën kryhen leje vjetor... Trupi gjykues ka vërejtur gjithashtu se, përtej kryerjes së veprimeve të para, por edhe bindjes së brendshme, subjekti ka zbatuar detyrat e lëna pas kthimit nga Gjykata dhe, për pasojë, ka konkluduar në ngritjen e akuzës “mashtrim” ndaj shtetasit ***.**, duke i njoftuar edhe akuzën. Po ashtu, trupi gjykues ka vërejtur se Gjykata Apelit, në arsyetimin e vendimit të saj, nga njëra anë orienton se duhej të ishte vendosur pushimi i çështjes dhe jo i mosfillimit të saj, por, nga ana tjetër, vijon të lërë detyra të tjera për hetim. Aktualisht, sipas procesverbaleve gjyqësore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se çështja vijon të jetë nën gjykim³² [...].*

³⁰ Nga aktet duket se kjo kërkesë nuk është marrë në konsideratë dhe subjekti ka vazhduar të jetë në cilësinë e prokurorit të çështjes.

³¹ Subjekti ka paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit Urdhrin për regjistrimin e emrit të personit në procedimin penal; Kthim përgjigje nr.*** prot., datë **.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, në të cilën thuhet se janë bashkëlidhur kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore referuar çështjes penale me nr. (***-***-**-2021)*** regj. Themeltar, me datë regjistrimi **.6.2021, me të pandehur shtetasin ***.**.

³² Referohuni vendimit të Komisionit, f. 71.

34.11.1 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se, për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit dhe për sa kohë çështja vijon të jetë në proces gjyqësor, Komisioni nuk ka kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit.

34.12 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se në rastin konkret duket se pretendimet e denoncuesit mbi mungesën e veprimeve hetimore dhe zvarritjen e procesit gjejnë mbështetje në aktet në dosje dhe vlerëson se Komisioni ka kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit.

34.13 Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit, tashmë, ka shprehur qëndrimin e tij mbi procedimin penal, pasi ka marrë vendim për mosfillimin e hetimeve, ka kundërshtuar vendimet e gjykatave për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, si dhe vetëm bazuar në ankimet e ushtruara nga kallëzuesi dhe detyrave të lëna nga Gjykata, ka konkluduar se duhet ngritur akuza për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Këto rrethana nuk e bëjnë këtë çështje “nën shqyrtim”, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i aneksit të Kushtetutës, pasi mungesa e veprimeve hetimore të rezultuara apo zvarritja e procesit, nuk janë të ndërvarura nga ecuria e shqyrtimit gjyqësor.³³

34.14 Nga aktet ka rezultuar se ky procedim është regjistruar më datë **7.2017 dhe vendimi i mosfillimit është marrë më datë **9.2017. Ashtu sikurse Gjykata e Apelit ka vlerësuar, ky vendim është përtej afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 291 i K. Pr. Penale. (*Gjykata e ka llogaritur afatin nga data 1 gusht, moment kur kanë hyrë në fuqi ndryshimet e reja ligjore.*) Komisioneri Publik vlerëson se koha e administrimit të këtij kallëzimi, *gati dy muaj*, deri në datën e marrjes së vendimit për mosfillimin e procedimit penal, në kushtet ku për vendimin e mosfillimit nuk kërkohet kryerja e veprimeve hetimore, dhe subjekti e ka arsyetuar kallëzimin si konflikt civil, ka qenë më se e mjaftueshme për të konkluduar mbi rastin dhe për të zbatuar afatet procedurale, në konsideratë dhe të pretendimeve të subjektit mbi lejen vjetore.

34.15 Fakti që subjekti ka kryer veprime hetimore, ashtu si Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar, nënkupton që procedimi *de facto* ka filluar dhe prokurori gjendet në kushtet kur duhej të analizonte dhe argumentonte, më së paku, mbi pushimin e procedimit penal dhe jo mbi mosfillimin e tij.

34.16 Subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore shtesë të lëna detyrë nga Gjykata, ka konkluduar në datën **9.2020 (3 vjet pas regjistrimit të procedimit penal), se shtetasit ***.*** duhet t'i njoftohet akuza për veprën penale të “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në gjendjen që janë aktet, duket se në procedimin konkret duhet të ishin ndërmarrë disa veprime hetimore, në mënyrë që të përcaktohej saktë nëse do kishte ose jo përgjegjësi penale për personat e përfshirë.

34.17 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi mosrespektimi i afateve ligjore, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

³³ Referohuni vendimit (JR) nr. 28/2020, prg. 14.7.

35. Denoncim i shtetasit *** ** (***.***.)

35.1 Denoncuesi pretendon se procedimi penal nr. ***, datë **.5.2008, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, nuk është ndjekur e trajtuar, duke fajësuar disa subjekte rivlerësimi, ndër të cilët edhe subjektin e rivlerësimit.

35.2 Denoncimi i referohet, ndër të tjera, një aksidenti automobilistik, të ndodhur në datën **.10.2007, rreth orës 14:00, në rrugën “*** **”, të Qarkut Fier, ku një automjet ka aksidentuar për vdekje motoçiklistin ***.*** Denoncuesi pretendon se Policia dhe Prokuroria, nuk kanë vepruar dhe nuk është marrë në ndjekje penale autorin.

35.3 Komisioni ka administruar fashikullin penal, që i përket procedimit nr. ***/2008, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Fier.

35.4 Nga hetimi i Komisionit³⁴ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2008, me arsyetimin se mungon lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimeve të kundërligjshme të drejtuesit të mjetit dhe pasojës së ardhur. Meqenëse nuk është bërë e mundur të këqyrej vendi i ngjarjes, pasi është prishur, dhe njëkohësisht nga marrëveshja e lidhur mes palëve për ta zgjidhur çështjen privatisht, nuk mund të vërtetohet se pasojat kanë ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, por edhe të identifikohet subjekti penal.

35.4.1 Ky vendim është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme me vendimin e saj datë **.4.2010 (bazuar në ankimin e shtetasit ***.***.). Ndër argumentet e dhënë në shfuqizimin e vendimit, referohet se nuk janë kryer veprimet e duhura hetimore në lidhje me autorin e aksidentit automobilistik, kush kanë qenë dëshmitarë, pse është larguar autori nga vendi i aksidentit, kur dhe kush i ka lëvizur mjetet motorike nga vendngjarja, ku dhe nga kush janë riparuar dëmtimet e mjetit, kur ka shkuar policia në vendngjarje, nuk është hetuar nëse personi ka qenë i pajisur me leje për drejtimin e automjetit, nuk është marrë dokumentacion i automjetit në DPSHTRR etj.

35.4.2 Nga hetimi ka rezultuar se çështja penale i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Vlorë³⁵, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2011, në ngarkim të shtetasit ***.***., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 të Kodit Penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Vlorë ka dërguar në Gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale, për arsye se është provuar që shkak determinant i aksidentit të ndodhur ka qenë parakalimi i gabuar dhe qarkullimi pa patentë i shtetasit ***.***. dhe se nga hetimet është vërejtur që janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale prej të pandehurit ***.***. Në këto rrethana, ky i pandehur mbetet i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, bazuar në nenin 290/1 të K. Penal.

35.5 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, në konkluzionet përfundimtare, datë **.12.2011, ka kërkuar deklarinimin “Fajtor” të të pandehurit ***.***., për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 600.000 lekë gjobë.

³⁴ Referohuni f. 72 të rezultateve të hetimit dhe f.71 në vendimin e Komisionit.

³⁵ Për shkak të ngritjes së Seksionit të të miturve në këtë rreth.

35.6 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, pasi duket se në këtë çështje nuk janë kryer hetimet e plota për identifikimin e autorit, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

35.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Shpjegoj se vendimin e pushimit të procedimit penal e kam marrë bazuar në bindjen time të brendshme mbi bazën e provave të administruara. Pavarësisht vendimmarrjes së ndryshme të Prokurorisë Vlorë, kam çmuar se në kushtet kur nuk kishte këqyrje të vendit të ngjarjes, ishte e pamundur të vërtetohej akuza e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Vendimin e pushimit ia kam njoftuar palëve të cilët kanë ushtruar të drejtën e ankimit. Përveç faktit se kjo dosje është jashtë periudhës së rivlerësimit, dua të theksoj për Komisionin se kjo është e vetmja çështje e njoftuar nga Komisioni, ku në përfundim është vendosur ndryshe nga vendimmarrja ime. Në këto kushte, në përfundim të analizës së sipërcituar, Komisioni duhet të arrijë në konkluzionin se kam arritur nivel të mirë të të vlerësimit profesional [...].*

35.8 Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve, ka arsyetuar se kemi të bëjmë me një çështje të vitit 2008, kontrolli i vendimmarrjes së subjektit nga ana e drejtuesit më të lartë të institucionit, i vlerësuar në një tjetër mënyrë, duhet parë në proporcionalitet me pretendimin e subjektit se në vendimmarrje ka vendosur jo vetëm sipas bindjes së tij të brendshme, por edhe provave të administruara. Kjo çështje duket se nuk mund të ndikojë si një shkak determinant në rivlerësimin e subjektit.

35.9 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij.

35.9.1 Së pari, Komisioneri Publik, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se pavarësisht se kjo çështje i përket vitit 2008, institucionet e rivlerësimit kanë detyrimin ligjor për ta marrë në shqyrtim dhe për ta vlerësuar atë³⁶, referuar pikës 1, të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, që lidhet me denoncimet e publikut.

35.9.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, rezultateve të hetimit administrativ dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

36. Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik, duke konstatuar mangësi për kriterin e pasurisë, problematika në kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe në raport me sjelljen e pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit në marrëdhënie me të tretë, arrin në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Bejko, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.

³⁶ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr.16/2021, prg. 9.

IV. Kërkimi i ankimit

37. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm;

38. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

39. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

40. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

41. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.5.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Bejko.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO